LIGJ
Nr. 85/2023

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9363, DATË 24.3.2005, "PËR DËRGIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË JASHTË VENDIT, SI DHE PËR MËNYRËN E PROCEDURAT E VENDOSJES DHE KALIMIT TË FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 12, pika 3, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në shkronjën "ç" të pikës 1 të nenit 2, në titull dhe në pikën 1 të nenit 9 dhe në shkronjën "ë" të nenit 11 fjalët "misione humanitare ndërkombëtare" zëvendësohen me fjalët "misione dhe operacione humanitare ndërkombëtare dhe emergjencash civile".

Neni 2

Në titull dhe në pikën 1 të nenit 15 fjalët "misione humanitare" zëvendësohen me fjalët "misione dhe operacione humanitare dhe emergjencash civile".

Neni 3

Pika 4 e nenit 16 ndryshohet si më poshtë:
"4. Forcat ushtarake të huaja gjatë kalimit transit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë shoqërohen nga Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nëse kërkohet nga shteti përkatës.".

Neni 4

Në pikën 1 të nenit 19 fjalët "mjetet ushtarake të huaja (automjete, anije)" zëvendësohen me fjalët "automjetet ushtarake të huaja".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 341 datë 30.11.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.